



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 934 / 5 Prot.

Tiranë, më 17. 12. 2018

V E N D I M

Nr. 206, Datë 17.12.2018

PËR
AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË TË
USHTRUAR NË BASHKINË SELENICË

**Për periudhën nga data 01.01.2017 deri në datën 30.09.2018, ndërsa për prokurimet
publike nga data 01.01.2016 deri në datën 30.09.2018**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Financiar dhe të përputhshmërisë", në Bashkinë Selenicë, sipas programit të auditimit nr. 934/1 prot., datë 01.09.2018, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2018, ndërsa për fushën e prokurimeve publike për periudhën 01.01.2016 deri më 30.09.2018.
- II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT

Opinionit kualifikuar mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Selenicë për vitin ushtrimor 2017, ku përfshihet pasqyra e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve, pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat në pasqyrat

financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Selenicë, të standardeve dhe ligjit të kontabilitetit mbi pasqyrat financiare, në përgjithësi ato japin një pamje të drejtë dhe të sqartë të pozicionit financiar të performancës financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare më datën 31.12.2017. Kjo referuar Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësi që varen prej tyre, si dhe të njësi të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”, duke përjashtuar disa anomali materiale, por jo të përhapura, në plotësimin e tyre, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar për pasqyrat financiare. I njëjti opinion vlen edhe për fushën e buxhetit. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë

Baza për dhënien e opinionit

Bashkia Selenicë nuk ka marrë masat e duhura për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”. Llogaria 210 “Toka, troje, Terrene” pasqyron vetëm asetet e ish Bashkisë Selenicë, në vlerën 140,307,952 lekë, por nuk janë përfshirë dhe as janë llogaritur vlerat e aseteve për ish komunitat. Gjithashtu për asetet të cilat nuk janë paraqitur në bilanc, nuk është hartuar regjistër i aktiveve. Llogaria 211 “Pyje, Kullota Plantacione” ka vlerën 0 lekë, por paraqitja e kësaj vlere nuk është e saktë, sepse bazuar në VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, në pronësi të Bashkisë Selenicë janë transferuar 500 prona me sipërfaqe pyjore dhe kullosore, të cilat nuk paraqiten në bilancin e vitit 2017. Nga njësi vendore nuk është hartuar regjistër i aktiveve për këto prona.

- Janë transferuar aktive në vlerën kontabël 526,501,279 lekë nga Bashkia Selenicë në shoqërinë “Ujësjellësi Selenicë” SHA, nuk është hartuar dokumentacion për transferimin e tyre. Në këtë mënyrë, ruajtja dhe ekzistenca e këtyre aktiveve kanë rrishtë të lartë nga humbja, keq përdorimi etj.

- Llogaria e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara (AQPT) 202 “Studime e projekte” si rezultat i kontabilizimit të gabuar, paraqet më shumë vlerën 37,054,686 lekë, e cila duhet të paraqitet në zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, pasi përfaqëson vlerën e 74 projekteve, investimet e të cilave kanë përfunduar. Keq klasifikimi në këtë llogari, ka sjellë gjithashtu efekte edhe në keq llogaritjen e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara, në llogarinë 209 në bilanc, e cila në mënyrë të pa saktë ka vlerën 19,025,984 lekë, por në fakt duhet të kishte vlerën 49,848 lekë.

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në datën 31.12.2017 ka vlerën 136,088,739 lekë, nga e cila vlera 126,881,393 lekë përbën detyrime për taksat dhe tarifatat vendore. Nga të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave, konstatohet se vlera totale e detyrimeve të taksapaguesve për taksat dhe tarifatat vendore në datën 31.12.2017 është në vlerën 268,203,000 lekë. Për sa më sipër diferenca prej 141,321,607 lekë detyrime për taksat dhe tarifatat vendore nuk është kontabilizuar.

- Ka diferenca midis buxhetit të planifikuar dhe atij të realizuar, të ardhurat për vitin 2017, janë realizuar në vlerën 69,545 mijë lekë ose 21,1% të vlerës së planifikuar, ndërsa për periudhën janar-shtator viti 2018, në vlerën 45,980 mijë lekë, ose në masën 62,2% të vlerës së planifikuar. Nuk është lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, duke u krijuar të ardhura të munguara në vlerën 582,869,000 lekë. Si rezultat Bashkia Selenicë ka një detyrim të faturave të pa likuiduara në vlerën 36,878,690 lekë, në të cilën përfshihen detyrime të ish komunave përpara shkrirjes së tyre, si dhe detyrime të vetë Bashkisë Selenicë

për periudhën 2017-2018. Vlera e mësipërme përbëhet nga 15,882,174 lekë detyrime për investime, 164,735lekë detyrime për mallra, 11,201,581 lekë detyrime për shërbime, 9,630,200 lekë detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore.

Përgjegjësitë e drejtuesve të njësisë vendore

Drejtimi i njësisë vendore Bashkia Selenicë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH mbi auditimin e pasqyrave financiare

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar.

Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme mbi pasqyrat financiare në tërësi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Llogaria e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara (AQPT) 202 “Studime e projekte”, në bilancin e vitit 2017 ka vlerën 37,386,874 lekë, por në këtë llogari, si rezultat i kontabilizimit të gabuar, është përfshirë edhe vlera prej 37,054,686 lekë, e cila duhet të paraqitet në zërat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, pasi përfaqëson vlerën e 74 projekteve, investimet e të cilave kanë përfunduar. Vlera e kësaj llogarie në bilanc duhet të jetë 332,188 lekë, pasi për mungesë fondesh, vetëm një investim që lidhet me këtë vlerë projekti nuk është realizuar. Keq klasifikimi në këtë llogari, ka sjellë gjithashtu efekte edhe në keq llogaritjen e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara, në llogarinë 209 në bilanc, e cila në mënyrë të pa saktë ka vlerën 19,025,984 lekë. Kjo pasaktësi lidhet me faktin se baza mbi të cilën është llogaritur amortizimi, përfshin në mënyrë të gabuar edhe vlerën prej 37,054,686 lekë, si dhe për llogaritjen e amortizimit është përdorur norma 10%, në vend të normës 15%. Llogaria 209 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara”, në fakt duhet të kishte vlerën 49,848 lekë (332,188 x 15%).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre, si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” i ndryshuar; rubrika 3- Procedurat e rakordimit dhe të mbylljes së llogarive; kërkesat e nenin 7, 9, 10 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin nr. 22, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”(Më hollësisht trajtuar në pikën A.2. faqe 16-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Drejtoria e financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e projekte”, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar. Për vlerën 37,054,686 lekë, llogaria 202 “Studime

e projekte” duhet të pakësohet dhe kjo vlerë të paraqitet te llogaria e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara sipas investimeve që ju përkasin projektet.

1.2.Rekomandim: Drejtoria e financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 209 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara”, duke marrë për bazë faktin se në datën 31.12.2017 kjo llogari duhet të paraqiste vlerën 49,848 lekë dhe jo 19,025,984 lekë. Gjithashtu të bëhen sistemimet e nevojshme edhe në vlerën e amortizimit të akumuluar. Për llogaritjen e amortizimit të AQPT të përdoret metoda lineare, në masën 15 për qind për secilin aktiv më vete.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2018

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Selenicë nuk ka marrë masat e duhura për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”. Llogaria 210 “Toka, troje, Terrene” pasqyron vetëm asetet e ish Bashkisë Selenicë, në vlerën 140,307,952 lekë, por nuk janë përfshirë dhe as janë llogaritur vlerat e aseteve për ish komunat sot Njësi Administrative të Bashkisë Selenicë. Gjithashtu për asetet të cilat nuk janë paraqitur në bilanc, nuk është hartuar regjistër i aktiveve. Llogaria 211 “Pyje, Kullota Plantacione” ka vlerën 0 lekë, por paraqitja e kësaj vlere nuk është e saktë, sepse bazuar në VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, në pronësi të Bashkisë Selenicë janë transferuar sipërfaqe pyjore dhe kullosore sipas listës së inventarit paraqitur në shtojcën nr. 55 të kësaj VKM, me numër rendor nga 1 deri 500, pra 500 prona, të cilat nuk paraqiten në bilancin e vitit 2017. Nga njësia vendore nuk është hartuar regjistër i aktiveve për këto prona dhe për këtë arsye nuk mund të përcaktohet vlera e cila nuk është paraqitur në bilanc për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”. Nuk ka një listë përfundimtare nga njësia vendore se cili është numri i pronave të cilat janë të pa regjistruara në ZVRPP.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre, si dhe të njësiteve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” i ndryshuar, rubrika 3- Procedurat e rakordimit dhe të mbylljes së llogarive; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 7, 9, 10; UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III. Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, pika 26-30 (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.2. faqe 16-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2.1. Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” dhe të llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, në bazë të gjendjes reale të pasurisë së institucionit, duke përfshirë edhe pronat e ish komunave. Gjithashtu për këto prona të hartohet regjistri i aktiveve me të dhënat e nevojshme si vendndodhja e pronës, sipërfaqja, vlera e secilës pronë etj. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale, si dhe të merren masa për regjistrimin e tyre në ZVRPP Vlorë. Nga titullari të analizohet kjo situatë dhe të nxirren përgjegjësitë.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2018

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2016, janë marrë në përdorim nga shoqëria Ujësjetësi SHA Selenicë, aktive të Bashkisë Selenicë, në vlerën kontabël 526,501,279 lekë. Për transferimin e këtyre aktiveve ka dalë urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 1321, datë 15.07.2016 “Për krijimin e komisionit për kalimin e aseteve të ish komunave, Ujësjetësit SHA Selenicë”, por as në vitin 2016 dhe as në vitin 2017 nuk është hartuar procesverbal për transferimin e tyre. Për këtë arsye këto aktive edhe pse nuk administrohen nga njësia vendore, vazhdojnë të pasqyrohen ende në pasqyrat financiare të saj, duke bërë që llogaritë e aktivitetit të bilancit (llogaria 213, 214, 218 dhe 32), të pasqyrojnë aktive të cilat realisht nuk ekzistojnë në njësinë

vendore, por në një tjetër institucion. Në këtë mënyrë inventarizimi fizik nuk përputhet me inventarizimin kontabël, ruajtja dhe ekzistenca e këtyre aktiveve kanë rrisht nga humbja, keqpërdorimi etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisë që varen prej tyre, si dhe të njësisë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” i ndryshuar; rubrika 3- Procedurat e rakordimit dhe te mbylljes se llogarive; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, rubrika -Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”.

Grupimi i aktiveve të transferuara:

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për 515,755,627 lekë;

Llogaria 214 “Instalime makineri pajisje” për shumën 9,831,852 lekë;

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” për vlerën 757,600 lekë;

Llogaria 32 “Objekte inventari” për vlerën 156,200 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.2. faqe 16-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

3.1. Rekomandim: Titullari i njësisë vendore të analizojë situatën e mos hartimit të dokumentacionit të duhur për transferimin e aktiveve nga njësia vendore dhe të nxirren përgjegjësitë. Bazuar në rregullat në fuqi, në urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 1321, datë 15.07.2016 “Për krijimin e komisionit për kalimin e aseteve të ish komunave Sha Ujësjellësit Selenicë”, të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia Selenicë në shoqërinë “Ujësjellës Selenicë” SHA për vlerën kontabël 526,501,279 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit të këtyre aseteve, duke i hequr nga inventarët e Bashkisë, pasi të jetë marrë konfirmimi i fletëhyrjes nga shoqëria “Ujësjellës” SHA Selenicë.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2018

4. Gjetje nga auditimi: Në përfundim të inventarizimit vjetor të vitit 2017 janë pasqyruar rezultatet e inventarizimit për aktivet e konstatuara mangët, midis të cilave edhe një mjet në vlerën kontabël 1,000,000 lekë. Mungesa e këtij aktivi ka të bëjë me humbje (qysh në ekzistencën e ish komunave) të një mjeti në ish komunën Brataj, konstatuar nga Bashkia Selenicë në inventarizimin e vitit 2016, por në këtë periudhë nuk janë kryer veprime të mëtejshme për pasqyrimin e vlerës 1,000,000 lekë në pasqyrat financiare në mbyllje të vitit 2016. Pra ngjarja ekonomike nuk është regjistruar në periudhën e saktë kontabël (viti 2016), atëherë kur ka ndodhur dhe është konstatuar, por në periudhën kontabël pasardhëse, në vitin 2017. Regjistrimet jo në periudhën e duhur kontabël është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisë që varen prej tyre, si dhe të njësisë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” i ndryshuar; rubrika 3- Procedurat e rakordimit dhe te mbylljes se llogarive; Ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 7, 9, 10; UMF nr.2, datë 06. 02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, rubrika “Përgjegjësia e Nëpunësit Zbatues të njësisë së qeverisjes së përgjithshme”, pika “ë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.2. faqe 16-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

4.1. Rekomandim: Në rastet e kryerjes së inventarizimeve për aktivet e njësisë vendore, Drejtoria e Financës të pasqyrojë menjëherë rezultatet e inventarizimit në pasqyrat financiare të atij viti në të cilin është kryer inventarizimi dhe është konstatuar ngjarja ekonomike.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në datën 31.12.2017 ka vlerën 136,088,739 lekë, nga e cila vlera 126,881,393 lekë përbën detyrime për taksat dhe tarifatat vendore nga subjekte privat dhe familjarë. Nga të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave, konstatohet se vlera totale e detyrimeve të taksapaguesve për taksat dhe tarifatat vendore në datën 31.12.2017 është në vlerën 268,203,000 lekë, nga e cila vlera 46,331,000 lekë detyrim nga subjektet private dhe vlera 221,872,000 lekë detyrim nga subjektet familjar. Për sa më sipër diferenca prej 141,321,607 lekë detyrime për taksat dhe tarifatat vendore nuk është

kontabilizuar nga drejtoria e financës. Në këtë mënyrë, pasqyrat financiare për llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk paraqesin vlerën e saktë të debitorëve real të institucionit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre, si dhe të njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” i ndryshuar, rubrika 3- Procedurat e rakordimit dhe të mbylljes së llogarive (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.2. faqe 16-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

5.1. Rekomandim: Drejtoria e financës të marrë masa për sistemimin e llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke pasqyruar vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të kategorisë privat dhe familjar. Pasqyrimi në pasqyrat financiare të detyrimeve debitore, të bëhet në bazë të dhënave shkresore të Drejtorisë së të Ardhurave e cila ndjek këtë proces. Nga titullari të analizohet kjo situatë dhe të nxirren përgjegjësitë.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2018

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pagesa e pagave neto të personelit për muajin nëntor 2016, në vlerën 4,540,275 lekë (sigurimet dhe TAP janë shlyer në kohë), është kryer në vitin 2017, me arsye të mungesës së fondeve, pasi burimi i financimit janë të ardhurat e veta të njësisë vendore. Kjo situatë vjen nga mos marrja e masave të plota për arkëtimin e të ardhurave sipas planit të parashikuar në buxhet, duke bërë që të mos ketë përputhje midis buxhetit të planifikuar dhe atij të realizuar në fakt. Këto parregullsi krijojnë detyrimeve të prapambetura për periudhat e tjera kontabël të mëvonshme, duke rënduar buxhetin e vitit pasardhës, si dhe vënë në vështirësi financat familjare të punonjësve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me detyrimin e njësisë vendore për zbatimin e buxhetit të miratuar në këshillin e bashkiak, si dhe nenin 116 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.2. faqe 16-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

6.1. Rekomandim: Bashkia Selenicë të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për pagesën e vonuar të pagës neto të punonjësve për muajin nëntor 2016. Në të ardhmen të bëjë një planifikim më të studiuar për të ardhurat dhe shpenzimet, duke i dhënë përparësi në radhën e shpenzimeve, pagesës së pagave të punonjësve. Të marrë masat e duhura ligjore për realizimin e të ardhurave dhe të eliminohen praktikatat e kryerjes së shpenzimeve të vonuara për pagat e punonjësve.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Selenicë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, rregullore e arkivës, regjistri i riskut, harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit. Mungojnë rregullat që përcaktojnë frekuencën e raportimit të menaxherëve kryesor të titullari, llojet e raporteve për informimin e tij. Ka mangësi nga stafi për njohjen e ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe manualin përkatës në zbatim të këtij ligji. Praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, pasi nuk janë hartuar programe trajnimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, 16, 22, 23 dhe 24 (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.1. faqe 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

7.1. Rekomandim: Titullari i njësisë vendore të nxirren përgjegjësitë dhe të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe rritjes profesionale të punonjësve nëpërmjet trajnimeve përkatëse. Të hartohen rregullave për ruajtjen e aktiveve, të hartohet rregullore e arkivës dhe kodit të etikës. Të hartohet regjistri i riskut dhe gjurma e auditimit për secilën drejtori dhe në nivel institucioni. Të përcaktohen llojet e raporteve që duhet të përgatiten për titullarin nga menaxherët kryesor dhe shpeshësia e tyre (mujor, tremujor etj.).

8. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Selenicë në vitin 2017 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës gjashtë punonjës, (me detyrë k/inspektor i policisë bashkiake, inspektor, jurist, veteriner), por nga auditimi u konstatua se asnjë nga këta punonjës, përpara largimit nuk ka bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal: dorëzimin e dosjeve shkresore, elektronike, pra të gjithë punës së krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen dhe transmetimin informacionit dhe bazës së të dhënave të krijuara në institucion, por ndërprerje të saj dhe rrjedhimisht ndikojnë në performancën e institucionit. Punonjësit e rinj të marrë rishtas në punë, përballen me vështirësinë e mungesës së informacionit të duhur, duke mos e njohur si duhet situatën e periudhës së paraardhësve të tyre. Në këtë mënyrë nuk krijohet një vazhdimësi kronologjike e transmetimit të punës së kryer nga një punonjës te tjetri, por ndërprerje e saj, në varësi të shpeshëtisë së ndërrimit të stafit, e cila sjellë edhe pasoja reale në punën e sektorëve përkatës të njësisë vendore. Në institucion nuk ka rregulla të shkruara për veprimet e punonjësve përpara largimit dhe detyrat e strukturave përkatëse të financës dhe burimeve njerëzore në raste të tilla. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 13; VKM nr. 360, datë 14.07.2000 “Për lirin nga shërbimi civil”, pikat 19, 20 dhe 21 “Dorëzimi i detyrës”; VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, pika 50; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 25 -Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.1. faqe 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandim: Në mënyrë që të parandalohen rastet e mos dorëzimit të detyrës nga punonjësi, kur ai ndërpret marrëdhëniet e punës, nga titullari të vendosen rregulla të brendshme të shkruara për këtë qëllim: të hartohet urdhër i veçantë apo të shtohet në rregulloren e brendshme dhe për këtë të njihen të gjithë punonjësit. Në këto rregulla të përcaktohet detyrimi që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”. Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i financës, burimeve njerëzore etj.

9. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e buxhetit vjetor për vitin 2017, në zërin e shpenzimeve, ka diferenca të dukshme midis treguesve të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit. Në total treguesit e buxhetit për shpenzimet për vitin 2017 janë planifikuar në vlerën 666,652 mijëlekë dhe janë realizuar në vlerën 544,512 mijë lekë, ose në masën 82%. Zëri i investimeve i cili përbën 45 % të shpenzimeve totale për këtë vit, është planifikuar në vlerën 330,017 mijëlekë dhe është realizuar në vlerën 242,133 mijë lekë, ose në masën 73%. Gjithashtu konstatohet planifikim i gabuar i shpenzimeve, duke marrë angazhime të tepërta në planifikim, të pa mbështetura në pritshmërinë reale të të ardhurave. Bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, në datën 31.12.2017 Bashkia Selenicë ka një detyrim ndaj të tretëve prej 64,314,089 lekë (llogaria 401-408, furnitor e llogari të lidhura me to), nga e cila vetëm gjatë vitit 2017 është krijuar detyrimi prej 64,149 mijë lekë. Në datën 30.09.2018 ku detyrim ka ardhur në ulje dhe ka vlerën 36,713 mijë lekë. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe mos realizimi i tyre sidomos në zërin e investimeve publike, për shkak të mos realizimit të të ardhurave sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve, ndërsa marrja e angazhimeve buxhetore përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndara krijojnë detyrime të prapambetura. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e metodologjisë së planifikimit të buxhetit dhe nenin 52, -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes

Vendore(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.1-B.1.3. faqe 26-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandim: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Selenicë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Të merren në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave dhe shpenzimeve në vitin e mëparshëm buxhetor. Angazhimet e reja buxhetore të merren vetëm pasi fondi që mbulon këto angazhime do të jetë në dispozicion në llogarinë përkatëse të njësisë vendore në degën e thesarit.

Në vazhdimësi çdo faturë shpenzimesh të likuidohet brenda afateve ligjore (30 ditë), duke shmangur transferimin e detyrimeve nga njëri vit buxhetor në tjetrin.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10.Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Selenicë, nga auditimi i mëparshëm financiar të kryer nga KLSH, sipas shkresës me nr.798/6 prot., datë 14.12.2017, janë rekomanduar 9 masa organizative nga të cilat 5 prej tyre rezultojnë të zbatuara, ndërsa 4 masa janë në proces zbatimi, konkretisht rekomandimi nr. 3, 4, 5 dhe 6. Rekomandimet e pa zbatuara kanë të bëjnë më anomali në pasqyrat financiare të vitit 2016, për llogaritë respektive të bilancit: 202 “Studime e projekte”, 210 “Toka, troje, terrene”, transferimin e vlerës së aktiveve prej 528,778,118 lekë në shoqërinë “Ujësjetllës” SHA dhe mos dokumentimin e veprimit kontabël, mos pasqyrimi i saktë i vlerës së debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore në pasqyrat financiare(Më hollësisht trajtuar në pikën D. faqe 52-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm dhe në vijim të merren masa të menjëhershme për zbatimin e tyre. Për këtë nga titullari të hartohet një plan pune i veçantë dhe të caktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Bazuar në informacionin e dhenë nga drejtorja e financës së Bashkisë Selenicë, konstatohet se nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), për periudhën 2015-2018, në faturat e energjisë elektrike të ndriçimit rrugor të qytetit, përveç vlerës së energjisë elektrike të konsumuar sipas aparatit matës, për çdo muaj është llogaritur edhe vlera tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv, për 47 kontrata në vlerën totale **164,100 lekë**, ndërkohë që ndriçimi rrugor i qytetit nuk ka të instaluar aparat televiziv. Shpenzimi i mësipërm është **efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore** dhe në kundërshtim me pikën 8, shkronja “b”, si dhe pikën 9 të udhëzimit nr. 29, datë 18.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv”, ku përcaktohet se “institucioni ka detyrimin ti përcjellë kompanisë OSHEE, brenda datës 15 janar të çdo viti, listën emërore të kategorive të përjashtuara nga pagimi i tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv, si dhe gjatë vitit përditësimet përkatëse nëse ka”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.1-B.1.3. faqe 22-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Bashkisë Selenicë, të marrë masa për ndërprerjen e faturimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv, në kontratat të cilat përjashtohen nga pagimi i kësaj tarife, bazuar në udhëzimit nr. 29, datë 18.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv”. Për këtë brenda datës 15 janar të çdo viti, si dhe në vazhdim gjatë vitit, nga njësia vendore ti përcillet kompanisë OSHEE lista emërore e kontratave të kategorive të përjashtuara nga pagimi i tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv, sipas shtojcës nr. 1, të udhëzimit të mësipërm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në

Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njesisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **773,849lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës nr. 2402 prot. datë 09.10.2017, me vlerë 17,457,287 lekë, me objekt “Rehabilitimi i rrugës së Kishës Selenicë”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Selenice dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “S. A.” SHPK & “J.” SHPK, u konstatua se:

a) Për zërin e punimeve: FV hekur betoni i zakonshëm Ø 6-10 mm, është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **120,585lekë pa TVSH**, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

b) Për zërat e punimeve: Mbjellje bari në skarpat; FV shkurre dekorative; Stola sipas specifikimeve dhe Tabela sinjalistike, janë likuiduar për punime të pakryera në shumën **125,411 lekë pa TVSH**, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me nenin 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe me kontratën e lidhur me datë 09.10.2017 me nr. prot. 2402. *(Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4. faqe 48-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 Rekomandim: Bashkia Selenice, të marrë masa që t’i kërkojë BOE “S. A.” SHPK & “J.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës **245,996lekë pa TVSH**, të përfituruar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës nr. 2402 prot. datë 09.10.2017, me objekt “Rehabilitimi i rrugës së Kishës Selenicë”. Për zërat: Mbjellje bari në skarpat; FV Shkurre dekorative; Stola sipas specifikimeve dhe Tabela sinjalistike, në vlerën 125,411 lekë pa TVSH do të konsiderohet dëm ekonomik deri në realizimin e plotë sipas projektit të zbatimit. Nëse BOE “S. A.” SHPK & “J.” SHPK, do të vetëtojnë pranë Bashkisë Selenicë realizimin e plotë të këtyre zërave punimesh dhe realizimi do bëhet brenda periudhës së garancisë së punimeve (afati maksimal i garancisë më 01.06.2019), vlera e mësipërme e dëmit ekonomik prej 125,411 lekë pa TVSH shuhet.

Brenda muajit janar 2019

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve sipas kontratës nr. 115 prot., datë 19.01.2017, lidhur midis Operatori Ekonomik “P.V.K.” SHPK dhe Autoritetit Kontraktor Bashkia Selenicë, me objekt “Rehabilitimi i rrugëve të lagjes Kotë”, me vlerë të kontratës 60,607,032 lekë me TVSH, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, në vlerën **265,167 lekë pa TVSH**, dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve lidhur midis palëve *(Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4. faqe 44-48 të Projekt Raportit të të Auditimit)*.

2.1. Rekomandim: Bashkia Selenice, të marrë masa që t’i kërkojë Operatori Ekonomik “P.V.K.” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit të kontratës, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e shumës **265,167 lekë pa TVSH**, përfituruar tepër si rrjedhojë e likuidimit dy herë për zërat e punimeve “Beton C 16/20 poshtë strukturave”.

Brenda muajit janar 2019

3. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Planifikimit të Territorit nuk ka llogaritur saktë taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja në momentin e dhënies së certifikatës së përdorimit të objektit për subjektin “M.” SHPK, me pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e njesisë vendore, në vlerën 130,656 lekë**. Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me

kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, UKM nr. 4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2015”, tabela nr. 1 dhe nr. 2; UKM nr. 3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016”, tabela nr. 1 dhe nr. 2; Vendimet e Këshillit të Bashkisë nr.1, datë 02.03.2017 dhe nr.29, datë 06.12.2017 “Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë në Selenicë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4. faqe 29-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandim: Bashkia Selenicë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **130,656 lekë**, nga subjekti “M.” SHPK, për mos llogaritje të saktë të detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja.

Brenda muajit janar 2019

4. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Selenicë janë kryer pagesa në vlerën 580,200 lekë, për qiramarrje objekti për përfituesin z.G. Sh., por prej institucionit nuk janë kryer ndalesat për tatimin në burim për llogari të buxhetit të shtetit për pagesat e likuiduara (në masën 15%). Këto veprime nuk janë në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, kreu II, neni 9, pika 2 dhe kreu IV, neni 33, pika 1, me pasojë **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, në vlerën 87,030 lekë** (*Më hollësisht trajtuar në pikën D. faqe 52-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **87,030 lekë** nga z. G. Sh. për mos pagesën e detyrimit për tatimin në burim për dhënie objekti me qira Bashkisë Selenicë.

Brenda muajit janar 2019

5. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Selenicë nuk janë marrë masa për arkëtimin e 5 gjobave të vendosura nga policia bashkiake për shkelje administrative, duke mos ndjekur rrugën ligjore për kthimin e tyre në titull ekzekutiv, veprim jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30, me pasojë **dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 45,000 lekë** (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 24-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Bashkia Selenicë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore deri në padi në gjykatë, për arkëtimin e gjobave të pa arkëtuara në vlerën **45,000 lekë**, sipas listës së lënë nga KLSH në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Brenda muajit janar 2019

C.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga njësia vendore janë marrë angazhimeve buxhetore në vlerë më të larta se vlera reale e fondeve në dispozicion dhe për këtë arsye në datën 30.09.2018, Bashkia Selenicë ka një detyrim të faturave të pa likuiduara në vlerën 36,878,690 lekë, vlerë e cila përbëhet nga 15,882,174 lekë detyrime për investime, 164,735 lekë detyrime për mallra, 11,201,581 lekë detyrime për shërbime, 9,630,200 lekë detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Këto detyrime i përkasin vitit 2017, 2018 si dhe periudhës së ish komunave, përpara shkrirjes së tyre. Krijimi i detyrimeve të prapambetura, rëndon buxhetin e viteve në vazhdim, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 50 - Angazhimet buxhetore, nenin 52 -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimin plotësues nr. 2,

datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, VKM 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 70 (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.1-B.1.3. faqe 26-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Titullari dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 36,878,690 lekë. Për këtë, bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe Udhëzimin Plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91-Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave. Në zbatim të pikës 88 të udhëzimit të mësipërm të bëjë publikimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura në faqen zyrtare të institucionit.

Në vijimësi gjatë vitit 2019

2. Gjetje nga auditimi: Si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Bashkia Selenicë për periudhën 2017-2018 ka shpenzuar vlerën **10,569,285 lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore**, nga e cila vlera 5,428,906 lekë i përket periudhës 2017, ndërsa vlera 5,140,379 lekë periudhës 2018. Kjo vlerë përfaqëson zbatimin e 19 vendime gjyqësore, 14 prej të cilave janë të mbartura nga periudhat e mëparshme, ndërsa 5 prej këtyre vendimeve janë të vitit 2017, por që lidhen me ngjarje të ndodhura përpara kësaj periudhe. Nga vendimet gjyqësore të zbatuara, 13 prej tyre lidhen me largime nga puna të punonjësve, ndërsa 6 vendime gjyqësore, të cilat përbëjnë edhe peshën më të madhe specifike në vlerë, janë për mos zbatim nga njësia vendore të detyrime kontraktuale, me pretendimin se ka mungesë dokumentacioni nga subjektet private. Përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.1-B.1.3, faqe 22-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Titullari i institucionit të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore në vlerën 10,569,285 lekë, të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë për efektin negativ që këto vendime kanë dhënë në buxhetin e njësisë vendore. Sektori juridik në rastet e proceseve gjyqësore të ndjek këtë proces në të gjitha shkallët e gjykimit. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari të nxirren përgjegjësitë administrative si dhe akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.2. MASA PËR RRIKUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Selenicë nuk ka lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi si vijon: a) Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) me afat 6-10 vjet, për të cilën tarifa vjetore është 440,000 leke/ha/vit në territor tokë inproduktive; b) Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektësh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, me afat 6-10 vjet, për të cilën tarifa vjetore është 78,000 leke/ha/vit në territor kullotë. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën 582,869,000 lekë dhe nuk janë në përputhje me VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4, (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 24-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Titullari i njësisë vendore të analizojë situatën e mësipërme dhe të nxjerrë përgjegjësitë. Nga titullari dhe strukturat e tjera përkatëse: Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, Zyra Juridike, të marren masa për lidhjen e kontratave të qirasë me subjektet e pajisur me leje minerare dhe të kërkohet me të gjitha rrugët e mundshme ligjore arkëtimin e vlerës 582,869,000 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë, sipas aneksit nr.2/2 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit shkurt 2019

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e të ardhurave rezultoi se për vitin 2017, janë realizuar në fakt 69,545 mijë lekë ose 21,1% të vlerës së planifikuar. Për periudhën janar-shtator viti 2018, realizimi është në vlerën 45,980 mijë lekë, ose në masën 62,2% të vlerës së planifikuar. Vlera debitore e subjekteve private për taksat dhe tarifave vendore në datën 31.12.2017 është në vlerën 46,332 mijë lekë, nga 418 subjekte, ndërsa në datën 30.09.2018 kjo vlerë është 58,762 mijë lekë nga 168 subjekte. Detyrimet debitore të taksës së tokës bujqësore gjendje më 31.12.2017 janë në vlerën 212,787 mijë lekë nga 7568 familje, ndërsa më datën 30.09.2018 këto detyrime janë në vlerën 227,787 mijë lekë nga 8018 familje. Gjithashtu për detyrimet të cilat nuk janë paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në vendimet e këshillit bashkiak, nuk është llogaritur dhe as arkëtuar gjoba prej 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar gjendje 31.12.2017, e cila përbënë vlerën 10,146,755 lekë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Selenicë. Për taksapaguesit familjar, Bashkia Selenicë nuk ka përcaktuar mënyra efektive për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore. Edhe pse është aksionare e vetme e shoqërisë “Ujësjellësi Selenicë ” SHA dhe bazuar në pikën (ii), neni 5 të ligjit 9642 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ka të drejtën dhe detyrimin e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, nuk ka realizuar përfshirjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore familjare në faturën mujore të ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat vendore dhe do të shtonte mundësinë e rritjes së investimeve dhe shërbimeve ndaj komunitetit. Performanca e strukturës së të ardhurave është jo në nivele të mira, duke mos përmbushur detyrën funksionale dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 24-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Selenicë, të marrë masa për kryerjen e akt rakordimeve për debitorët e taksave të bizneseve dhe të familjarëve, gjendje më 31.12.2017 dhe pasqyrimin në kontabilitet të debitorëve, në vlerën 46,332 mijë lekë. Për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Taksave Bashkia Selenicë të nxirren njoftim vlerësimit tatimore duke ndjekur **rrugët e mëposhtme:**

a-T’u dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-T’i dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesat për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të llogariten kamat vonesat, në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë (gjobë) bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH”, të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014.

d- Edhe pas njoftimeve zyrtare ne se bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Bashkisë (DPTT dhe Drejtoria Juridike), pasi te merren masat administrative apo sekuestro te bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

e- Drejtoria e PTT në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojnë listat emërore të debitorëve në mënyre elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të pikës 76, të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, të njoftojnë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

f- **Për kategorinë e taksapaguesve** familjar, Bashkia Selenicë të përgatisë dhe paraqesë për miratimin në këshillin bashkiak aktmarrëveshjen me shoqërinë “Ujësjetllësi Selenicë” SHA, duke i dhënë të drejtë kësaj shoqërie të kryejë rolin e agjentit tatimor, me përfshirjen në faturën e ujit të pijshëm edhe detyrimin për taksat dhe tarifatat vendore familjare.

Brenda muajit mars 2019

3. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Selenicë, konstatohet se deri më 30.09.2018, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë 174 persona për sipërfaqe ndërtimore gjithsej 27,456 m², me pasojë **të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 4,462,697 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe vendimet e këshillit të Bashkisë nr.1, datë 02.03.2017 dhe nr.29, datë 06.12.2017 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë”, (Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 24-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Bashkia Selenicë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore për subjektet, në vlerën totale të pa arkëtuar prej 4,462,697 lekë, e ardhur e munguar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e përdorimit të të ardhurave u konstatua se për periudhën janar 2017-gusht 2018 janë punësuar 65 punonjës të përkohshëm me kontratë, të cilët janë paguar me pagë mesatare 14,000 lekë/muaj, vlerë më të ulët se paga minimale 24,000 lekë dhe pa u deklaruar në organet tatimore, pra janë lejuar të punojnë “në të zezë”. Punësimi “në të zezë” ka sjellë mospagim të detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (vlera e mësipërme është e përjashtuar nga pagesa e TAP), me pasojë **të ardhura të munguara në fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në vlerën 4,833,976 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në nenin 10 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me pikën 5, të paragrafit II të VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”; VKM nr.399, datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi, (Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 24-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandim: Bashkia Selenicë të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për situatën e mësipërme. Në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë dhe me vetë punonjësit, të marrë masa për deklarimin e vonuar të punonjësve dhe për pagesën e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Të ndërpriten praktikatat e punësimit të punonjësve me pagë më të ulët se paga minimale dhe mos deklarimit të tyre në organet tatimore.

Brenda muajit shkurt 2019

5. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Selenicë, nuk është vepruar për të aplikuar gjopa ndaj subjekteve fizik dhe juridik, për shkeljet e

konstatuara në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi dhe të dokumentuara me proces verbale konstatimi. Vendimet e pezullimit të punimeve në ndërtim nuk janë shoqëruar me vendimin për dënim me gjobë, ku vlera e gjobës përcaktohet bazuar në vlerën e punimeve të kryera pa leje ndërtimi, por për çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, neni 52, pika 1, germa “e”; ligjit 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar”, neni 5 germa “b”, me pasojë, **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, për 17 raste në vlerën 8,500,000 lekë**(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 24-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandim:Bashkia Selenicë, zyra e IMTV, për shkeljet e konstatuara nga kundërvajtësit në kryerjen e punimeve pa leje ndërtimi, të marrë masa për vendosjen e gjobave në vlerën **8,500,000 lekë**,sipas aneksit nr. 2/5 të bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014,VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015,datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Selenicë, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: **për 3 punonjës** si më poshtë:

Nga “*Vërejtje*” deri në “*Largim nga shërbimi civil*”, **për punonjësit e mëposhtëm:**

1. Z. L. H., me detyrë drejtor i financë, në cilësinë e nëpunësit zbatues, *për shkeljet e mëposhtme:*

- Për mos zbatim të UMF 14 dt 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”; Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nenin 7, 9, 10; UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me pasojë anomali materiale në pasqyrat financiarë të vitit 2017: Në përfundim të investimeve të kryera nuk është sistemuar llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, duke paraqitur në këtë llogari në mënyrë jo të drejtë më shumë vlerën 37,054,686 lekë; bilanci nuk paraqet të gjithë pasurinë reale të institucionit për aktivet e llogarisë 210 “Toka, troje, terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”; Nuk është hartuar regjistër i plotë i aseteve të institucionit; Janë transferuar aktive nga Bashkia Selenicë në “Ujësjiellës Selenicë” SHA, në vlerën kontabël 526,501,279 lekë, por nuk janë hartuar procesverbalet e dorëzimit dhe nuk janë bërë ndryshimet në kontabilitet; Nuk është pasqyruar në kontabilitet detyrimi në vlerën 145,150 mijë lekë për debitorët e taksave dhe tarifave vendore.

2. Z. L. Gj., me detyrë drejtor i drejtorisë së taksave e tarifave vendore, *për shkeljet e mëposhtme:*

Për mos zbatim të VKM nr 391, datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4, pasi nuk janë marrë masa për evidentimin dhe lidhjen e kontratës së qirasë me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria

e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi në Bashkinë Selenicë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë, në vlerën 582,869,000 lekë;

- Për mos zbatim të detyrave funksionale dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, kreu XI- Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, me pasojë realizim në nivele të ulëta të të ardhurave, në masën prej 21 % në vitin 2017 dhe 62% në vitin 2018; Mos arkëtim i detyrimeve debitore në datën 30.09.2018 në vlerën 58,762 mijë lekë, e ardhur e munguar nga 168 subjekte private dhe vlerën 227,787 mijë lekë e ardhur e munguar nga 8018 familje; Mos aplikim i gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar gjendje 31.12.2017, me pasojë e ardhur e munguar në vlerën 10,146,755 lekë.

3. Z. K. B., me detyrë, drejtor i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit. për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos zbatim të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit të Bashkisë nr.1, datë 02.03.2017 dhe nr.29, datë 06.12.2017 “Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Selenicë”, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 4,462,697 lekë;

- Për mos zbatim të ligjit nr. nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, UKM nr.4, datë 30.9.2015 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2015”, UKM nr.3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i banesave, për vitin 2016”, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, në vlerën 130,656 lekë.

D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe **të nenit 13** të kontratës individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë**, që bazuar në performancën e punonjësit dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **për 1 punonjës si më poshtë:**

Nga “Vërejtje” deri në “Paralajmërim për largim nga puna” për:

1. Z. L. K., me detyrë, kryeinspektor i inspektoratit mbrojtjes së territorit vendor, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos zbatim të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, neni 52, pika 1, germa “e”; Ligjit 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", të ndryshuar”, neni 5 germa “b”, me pasojë, të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, për 17 raste në vlerën 8,500,000 lekë.

D.3. Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me Bashkinë Selenicë, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjëra prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja në mirëfunksionimin e institucionit, konsiderojmë të mos propozohet masë, si më poshtë:

1. Znj. E. Sh., me detyrë, Përgjegjëse e Sektorit të Financës

2. Z. M. H., me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e DST

3. Z. Xh. M., me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e DST

4. Z. A. V., me detyrë specialist i shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të komisionit për hartimin e DST.

5. Z. K. B., me detyrë përgjegjës i burimeve njerëzore, në cilësinë e anëtarit të KVO.

6. Z. A. I., me detyrë përgjegjës i sektorit të turizmit dhe sportit, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R